



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE
ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR
SPECIJALIZOVANO TUŽILAŠTVO

Numri: KSC-BC-2020-05
Prokurori i Specializuar k. Salih Mustafës

Vendos: Gjykatësi i procedurës paraprake
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Pjesëmarrësi parashtrues: Prokurori i Specializuar

Data: 6 maj 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Version i redaktuar publik i

**'Parashtrimeve lidhur me redaktimet e propozuara në vendimin e konfirmimit',
KSC-BC-2020-05/F00027, i datës 2 tetor 2020**

Zyra e Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të të akuzuarit
Julius von Bone

1. Në përputhje me urdhrin e konferencës për ecurinë e çështjes,¹ Zyra e Prokurorit të Specializuar ('ZPS') paraqet parashtrimet e mëposhtme me shkrim në lidhje me redaktimet e propozuara në vendimin e konfirmimit,² në mënyrë që vendimi t'u vihet në dispozicion mbrojtjes dhe publikut.
2. Që vendimi i konfirmimit të mund t'u vihet në dispozicion mbrojtjes dhe publikut, duhet të redaktohen emrat dhe informacioni që mund të zbulojë identitetin e viktimave ose dëshmitarëve të përshkruar në vendimin e konfirmimit. Këto redaktime do të ishin të ngjashme me ato që tashmë janë autorizuar përkohësisht me anë të vendimit të konfirmimit.³
3. Rrethanat e paraqitura në parashtrimin fillestar të Aktakuzës prej ZPS-së janë ende të pranishme.⁴ Ekziston rrezik real i ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve dhe viktimave, që sipas rregullës 105 përbën rrethanë të veçantë që përlij mosnxjerrjen e përkohshme të identitetit të dëshmitarëve dhe viktimave të përfshirë në këtë proces deri sa të urdhërohen masat e nevojshme mbrojtëse. Për këtë arsye, redaktimet e propozuara të vendimit të konfirmimit janë të domosdoshme në këtë fazë, për të garantuar integritetin e procesit dhe mbrojtjen e dëshmitarëve dhe viktimave.
4. Si masë paraprake, ZPS-ja gjithashtu kërkon që në versionet publike të mundshme të vendimit të konfirmimit të redaktohen disa numra ERN të dokumenteve, duke përfshirë numrat e transkripteve. Kjo masë është e domosdoshme deri sa të përfundojë procesi aktual i krahasimit me materialin konfidencial [REDAKTUAR] dhe përshtatjet e mundshme që duhen bërë [REDAKTUAR].
5. Në shtojcën 1, redaktimet e kërkuara për versionet konfidenciale të redaktuara të vendimit të konfirmimit janë shënuar me kuti të kuqe përreth tekstit përkatës. Përveç tekstit të shënuar me kuti të kuqe në shtojcën 1, ZPS-ja me respekt kërkon që

¹ Urdhër për caktimin e datës së konferencës për ecurinë e çështjes, KSC-BC-2020-05/F00023, 30 shtator 2020, publik ('Urdhri i konferencës për ecurinë e çështjes'), para.21(c).

² Vendim për konfirmimin e Aktakuzës kundër Salih Mustafës, KSC-BC-2020-05/F00008, 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* ('Vendimi i konfirmimit').

³ *Shih* Vendimin e konfirmimit, KSC-BC-2020-05/F00008, para.163.

⁴ Parashtrim i Aktakuzës për konfirmim dhe i kërkesave në lidhje me të, KSC-BC-2020-05/F00002, 14 shkurt 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* ('Parashtrimi fillestar i Aktakuzës'), para. 21-22.

në versionin e redaktuar publik të vendimit të konfirmimit të redaktohet edhe teksti i shënuar me ngjyrë të verdhë.

6. Ky parashtrim dorëzohet si rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* në përputhje me vendimin e konferencës për ecurinë e çështjes.⁵

Numri i fjalëve në origjinal: 377

/nënshkrim/

Xhek Smith

Prokurori i Specializuar

E enjte, 6 maj 2021

Në Hagë, Holandë.

⁵ Urdhri i konferencës për ecurinë e çështjes, KSC-BC-2020-05/F00023, para.21(c).